Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 5 lidhur me nenin 7, pika 3, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 4, lidhur me nenin 5, të Rregullores (QRK), Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, neneve 15 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 26.12.2018, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 **JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15, (pesëmbëdhjetë), vite të pronës së paluajtshme të komunës:

1.2 Objektin (depoja) në rrugën "Bajram Curri" në lagjen "Sllogja" në Suharekë, përballë objektit të Komunës, me sipërfaqe te përgjithshme prej; **279m²,** e cila është e ndërtuar në pjesët e parcelave kadastrale P-72116046-01161-5 dhe P-72116046-01161-6 dhe parkingun për rreth objektit me sipërfaqe te përgjithshme prej; **197m²,** i ndërtuar në pjesët e parcelave P-72116046-01161-4 dhe P-72116046-01161-5, zona kadastrale Suharekë e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, sipas certifikatës së pronës Nr.4740/2018 e datës 03.12.2018.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" dhe të Rregullores (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-016-81136
Më datë 26.12.2018.

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI